



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit

Adresa: Rruga "AbdiToptani" Nr.2, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site:ëëë.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____/2021

V E N D I M

Nr. 83, Datë 12.07.2021

PËR

**AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE
TË BREGDETIT "MBI VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË EKONOMIKO
FINANCIARE" PËR PERIUdhËN VITI 2020 DHE NË RASTE IDENTIFIKIMI RISKU
NË PERIUdhËN E MËPARSHME 2016 -2019**

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit Tiranë, rezultoi që veprimtaria e subjektit të audituar, ka qenë përgjithësisht efektive në drejtim çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, zbatimin e buxhetit, zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi në fushën e menaxhimit bregdetar, inventarizimi i llogarive të pasurive publike, procedurat e prokurimit, zbatimin e kontratave për punë publike dhe zbatimin e projekteve IPA.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*".

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Për vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar*", të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, Tiranë (në vijim AKB), sipas programit të auditimit 20/1, datë 26/01/2021, ndryshuar ne nr. 20/2, datë 08/03/2021, për veprimtarinë e ushtruar në vitin 2020 dhe në raste identifikimi risku edhe në periudhën e mëparshme 2016 -2019.

II. Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. Opinioni i Auditimit

Opinion mbi përputhshmërinë (Opinion i Modifikuar/Kualifikuar).

Në bazë të punës së kryer, ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së AKB, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të AKB-së, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Nga auditimi u rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i AKB-së, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme **përveç** çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit.

Baza për opinionin e përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-t). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130-Kodi Etik, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë” si dhe në mbështetje të Kodit të Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.2008.

Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një nivel të arsyeshëm për dhënien e **opinionit të modifikuar/kualifikuar**.

Në vijim konstatuam thyerje të kontrolleve të brendshme që konsistojnë në sa më poshtë:

Nga auditimi i përputhshmërisë, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), **janë konstatuar mangësi dhe parregullsi:**

- Aktiviteti i institucionit nuk ka qenë plotësisht efektiv në drejtim çështjeve që lidhen me planifikimin dhe realizimin e buxhetit, me mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare, zbatimin e politikave e të strategjive për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare, në hartimin e politikave e të strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e tyre, për bashkëpunimin me organet përkatëse për projektet dhe aktivitetet për mbrojtjen dhe zhvillimin e bregdetit dhe monitorimin e zbatimit të tyre, për monitorimin e respektimit të kriterëve ligjore për kryerjen e veprimtarive turistike detare, të cilat zhvillohen në zonën bregdetare, etj;

- Nuk janë realizuar fondet e alokuara për 10 projekte, që variojnë nga 45 % - 60 %, kryesisht në zërin shpenzime operative,

- Llogaritë e inventarizuara, rezultojnë të barabartë pa diferenca ndër vite, duke mos nxjerrë jashtë përdorimit vlera materiale;

- Pamjaftueshmërinë në përmbushje të funksioneve si një institucion që ka impakt në fushën e turizmit dhe ndikon direkt në rritjen e sigurisë së jetës së qytetarëve që frekuentojnë plazhet.

- Mungesa e auditimeve të mëparshme ka ndikuar direkt në mirë menaxhimin e njësisë publike dhe mangësitë e evidentuara do të ishin minimizuar nga punonjësit e administratës së këtij institucioni.

- Nga zbatimi i kontratave për punë publike dhe blerje të vogla, në 3 raste janë konstatuar shkelje dhe parregullsi lidhur me plotësimin me dokumentacionin teknik, si dhe rezultojnë diferenca volumesh të pa realizuara, që kanë sjell si pasojë një dëm ekonomik **me vlerë totale prej 48,325 lekë**.

- Institucioni nuk është plotësuar me strukturat përkatëse të miratuara dhe ka rezultuar me mungesë të personelit, si drejtues ashtu edhe profesional, në nivel ekzekutiv, gjë e cila ka

penguar ushtrimin e plotë të përgjegjësive dhe detyrave në fushën e menaxhimit bregdetar, duke mos miratuar një plan strategjik institucional, apo produkte të tjera në fushën e menaxhimit bregdetar.

- Veprimtaria ligjore e institucionit rezulton mjaft e kufizuar, duke vepruar thjeshtë si agjenci monitoruese, për rrjedhojë nuk është integruar me objektivat e Konventës të Barcelonës, kjo edhe për shkak të mungesës së një strategjie kombëtare, apo ligji të posaçëm për menaxhimin e integruar të bregdetit.

- Janë zhvilluar procedura prokurimi, ku në 5 raste, konstatohen parregullsi në lidhje me hartimin e dokumentacionit të tenderimit, si dhe gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave **në vlerën e përgjithshme 3,633,974**, nga të cilat në 2 raste janë krijuar efekte negative në administrimin e fondeve publike në vlerën 2,398,064 lekë.

- Megjithëse janë kryer monitorime të vazhdueshme, ato kanë rezultuar me efektivitet jo të lartë dhe me mangësi në lidhje me organizimin dhe shfrytëzimin e kapaciteteve, pasi ka patur mungesë të burimeve njerëzore, sipas strukturave të miratuara të degëve rajonale.

- Institucioni (AKB) nuk ka patur performancë të mirë në zbatimin e projekteve IPA dhe nuk janë përthithur fondet **me vlerë 356,698 euro** nga tre projekte, kjo e mbartur dhe nga performanca jo e mirë e administratës vitit 2016-2019.

- Procedurat e tenderimit për ekspertizë të jashtme (për projekte të financuara nga BE), nuk janë zhvilluar në përputhje të plotë me rregullat e PRAG-ut (Guida praktike për procedurat kontraktues të jashtme të BE-së), etj.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Drejtimi i AKB, është përgjegjës për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të AKB, në lidhje mbi menaxhimin e fondeve buxhetore për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues.

Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1-Gjetje: VKM nr. 171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, përmban dispozita që zvogëlojnë aksesin e lirë të qytetarëve në plazhe. Konkretisht, në VKM nr. 171, dt. 27.03.2019 në nenin 4 “Harta e përgjithshme për plazhet e lejuara”, pika 2, përcaktohet se *ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar si plazh privat/publik do të bëhet proporcionalisht, sipas raportit 80%/20% dhe në mënyrë perpendikulare me vijën bregdetare.*

Sa sipër kjo ndarje është në disproporcion dhe në zvogëlim të aksesit publik, një ndarje e padrejtë që i jep prioritet plazheve private, duke lenë pas dore të drejtat e qytetarëve në plazhe dhe duke rënduar buxhetin familjar të tyre me mbishpenzime, në kushtet e zonës bregdetare e cila përcaktohet si pronë shtetërore e patjetërsueshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë iniciativën ligjore dhe ti propozojë KM ndryshimin (apo përmirësimin) e pikës 2 te nenit 4 te VKM nr. 171, date 27.03.2019, me qëllim për të vendosur një raport të drejtë mes plazhit publik dhe plazhit privat, ku ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar si plazh privat/publik të bëhet proporcionalisht, në mënyrë perpendikulare me vijën bregdetare ,sipas një raporti të drejtë, ku gjithmonë të prevalojë interesi publik duke rritur aksesin e lirë të qytetarëve në plazhe, pa cenuar të drejtën e subjekteve private për zhvillimin e biznesit.

Brenda muajit Dhjetor 2021

2-Gjetje: Në VKM nr. 171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, në nenin 3 “Tipologjia e plazheve” janë përcaktuar tipet e plazheve: A, B, AB, e C, ndërsa në shtojcën 1 “Lista e plazheve”, bashkëlidhur vendimit, është përcaktuar lista e plazheve të lejuara për stacione plazhi por nuk ka një ndarje të këtyre plazheve sipas tipologjisë.

Sa sipër VKM nr. 171, datë 27.03.2019 mbetet i paplotësuar dhe kjo sidomos për plazhet e tipit C, ku nuk lejohet dhënia me qira e stacioneve të plazhit. Konkretisht, në nenin 3, germa (ç) përcaktohet se plazhi e tipit C është plazh i virgjër, për përdorim të lirë, ku nuk lejohet asnjë veprimtari për stacion plazhi. Por, siç u përmend më sipër lista e plazheve të tipit C si dhe të tipeve të tjera, nuk është pjesë e VKM-së, çka krijon paqartësi për identifikimin e tyre, duke lënë shteg për shpërdorimin e hapësirave në plazhet publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë iniciativën ligjore dhe ti propozojë KM ndryshimin (apo përmirësimin) e VKM nr. 171, dt. 27.03.2019, me qëllim plotësimin e listës së plazheve me tipologjitë përkatëse A, B, AB e C dhe sidomos për plazhin e tipit C, ku nuk lejohet asnjë veprimtari për stacion plazhi.

Brenda muajit Dhjetor 2021

3.Gjetje nga auditimi: Nisur nga rekomandimet e KLSH-së, AKB Tiranë, me shkresën e brendshme datë 04.02.2021, ka bërë sugjerimet e nevojshme dhe përgatitur Projekt-Ligjin “Për Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare”, në vijim të punës për përmirësimin e legjisllacionit dhe hartimin e një kuadri ligjor specifik për mbrojtjen e bregdetit.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit, ka kryer një analizë të legjisllacionit aktual, si rezultat i të cilit është arritur në përfundimin se është i nevojshëm përcaktimi i një modeli të ri mbi administrimin e plazheve dhe vijës bregdetare nëpërmjet një ligji specifik me këto objektiva të përgjithshme: Përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për administrimin e zonës bregdetare si dhe të kompetencave të tyre me qëllim mbrojtjen dhe shfrytëzim racional të zonës bregdetare, reformimi i strukturës aktuale menaxhuese të bregdetit (AKB), garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm të zonës bregdetare si dhe sigurimi i mbrojtjes dhe zhvillimit racional, përcaktimi për herë të parë i kufijve të bregut të detit dhe brezit të zhvillimeve të qëndrueshme, dhënia e një statusi të veçantë juridik zonës bregdetare, përcaktimi i bregut të detit si pronë e patjetërsueshme, ndalimi i ndërtimeve në bregun e detit si dhe disiplinimi i ndërtimeve në brezin e zhvillimeve të kontrolluara në harmoni me bregun e detit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë iniciativën ligjore dhe ti propozojë KM, hartimin e projekt-ligjit dhe dërgimin për miratim, duke rishikuar edhe një herë konformë legjisllacionit shqiptar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, si Konventa e Barcelonës "Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut, aderuar me ligjin nr. 10234/2010, ligjin nr. 111/2012 “Për

Menaxhimin e Integruar të Ujërave” i ndryshuar, Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, etj. akte relevante në fjalë.

Menjëherë

C.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Sipas rregullores së AKB, Kreu II “Organizimi dhe funksionimi i strukturave”, struktura e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit ka qenë organizuar në dy drejtori: (i) Drejtorinë e Planifikimit dhe Menaxhimit Territorial të Zonave Bregdetare dhe (ii) Drejtorinë e Legjislacionit dhe Monitorimit. Është konstatuar se në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit nuk janë përcaktuar në mënyrë specifike, të qartë dhe shteruese detyrat dhe përgjegjësisë e drejtorive përkatëse, ku të integroheshin objektivat dhe detyrat e përcaktuara në Ligjin Nr. 10234 datë 18.02.2010 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe” të konventës së Barcelonës “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut si p.sh. vlerësimi i risqeve mbi ndikimet e aktiviteteve njerëzore në bregdet, hartimi i strategjive etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 1, faqet 14-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që në përgatitjen e Rregullores së re të organizimit dhe funksionimit të brendshëm, të specifikojë në mënyrë të qartë dhe shteruese detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorive dhe strukturave përkatëse, të ketë implementim të plotë të ndryshimeve në ligjin e ri, në mënyrë që të ketë përshkrim të detyrave për secilën drejtori, duke integruar tek detyrat objektivat me Konventën e Barcelonës “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut”.

Brenda muajit Dhjetor 2021

2. Gjetje nga auditimi: Rregulloret për administrimin e hapësirave publike nuk janë të përditësuara me ndryshimet e reja në terren, të cilat bazuar në kuadrin e ri rregullator, VKM nr. 424, datë 27.5.2020 Për një shtesë në VKM nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, duhet të jenë në përputhje edhe me hartat e plazheve të miratuara nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik. Në mungesë të miratimit të këtyre rregulloreve, bëhet një shpërndarje e pa planifikuar e plazheve, e cila ndryshon nga viti në vit. Për rrjedhojë, si nga bashkitë ashtu edhe nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, bëhet i vështirë identifikimi i saktë dhe në kohë si i stacioneve të plazhit ashtu edhe hapësirës publike të plazhit duke sjellë problematikat e shfrytëzimit nga stacionet e plazhit të një sipërfaqeje përtej asaj të kontraktuar me bashkitë, me pasojë rritjen e informalitetit për të ardhurave të bashkive dhe moszbatimin e kriterëve ligjore nga ana e stacioneve të plazhit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 1, faqet 14-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që të përditësojë rregulloret e plazheve sipas hartave të miratuara nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik dhe të diferencojë sipërfaqen e plazhit për përdorim publik nga sipërfaqja për përdorim privat nga stacionet e plazhit, përmes një linje të qartë demarkacioni.

Brenda muajit Dhjetor 2021

3. Gjetje nga auditimi: Marrë parasysh faktin e rëndësishëm se pronësia detare e Shqipërisë është 12,900 km² dhe përbën rreth 45% të territorit të përgjithshëm ndërsa bregdeti ka një shtrirje tokësore minimalisht 427 km², konstatohet se veprimtaria e AKB, për shkak të bazës së kufizuar ligjore, duke vepruar thjesht si agjenci monitoruese, nuk ka qenë e integruar me objektivat e Konventës të Barcelonës, kjo edhe për arsye se në Shqipëri nuk ekziston një strategji kombëtare apo ligj i posaçëm për menaxhimin e integruar të bregdetit në kundërshtim me Konventën e Barcelonës mbi Menaxhimin e Integruar të Bregdetit, ku Shqipëria ka aderuar në vitin 2010.

Konkretisht, një detyrë mjaft e rëndësishme e parashikuar në këtë marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar ka të bëjë me krijimin dhe përditësimin e inventarit kombëtar të bregdetit. Një inventar i tillë ende nuk është krijuar apo përditësuar dhe nuk ka një përkufizim të saktë se çfarë përfaqëson ky inventar, duke qenë se është parashikuar në VKM Nr. 569, datë 17.07.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, në pikën 6.b ku përcaktohet detyra e AKB-së për të krijuar dhe përditësuar Inventarin Kombëtar të Zonës Bregdetare, një sipërmarrje kjo që në kushtet aktuale të AKB është plotësisht e pamundur për t’u realizuar për shkak të mungesës së kapaciteteve profesionale dhe buxhetore. Nga ana tjetër, inventari i bregdetit paraqitet problematik, për shkak se shumë zona kadastrale bregdetare nuk janë të regjistruara në sistem, si dhe shumë pasuri shtetërore nuk janë regjistruar në zyrat dhe Drejtoritë Vendore të kadastrës ASHK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të rakordojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës mbi situatën e zonave bregdetare të hedhura në sistemin e regjistrimit fillestar, si dhe t’i kërkojë bashkive bregdetare statusin e regjistrimit të pasurive publike, përfshirë ato të transferuara, me qëllim krijimin e një inventari paraprak të bregdetit.

Brenda muajit Dhjetor 2021

4. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për ushtrimin e kompetencave të reja të inspektimit në zbatim të VKM nr. 569, datë 17.07.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” nuk ka hartuar formatet standarde të mënyrës sesi do të realizohet inspektimi, niveli i gjobave që do të vendosen dhe kategorizimin e masave administrative për çdo shkelje të konstatuar për vijën bregdetare me rreth 120 plazhe në të cilat operojnë rreth 1300 stacione plazhi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa për krijimin e një modeli të inspektimit në bazë risku, si dhe të hartojë formatet standarde mbi mënyrën e ndjekur për procedurën e inspektimit.

Brenda muajit Dhjetor 2021

5. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit nuk ka një bazë të dhënash për kategoritë e stacioneve të plazheve, ku të evidentohet se cilët operatorë ekonomikë i përkasin kategorisë së hotelerive apo bizneseve bar-restorant dhe cilët i përkasin personave fizikë. Konstatohet se masivizimi i stacioneve të plazhit, pa patur një treg të konsoliduar të këtij shërbimi turistik, ka sjellë që stacioni i plazhit të shihet si një biznes sezonal e i përkohshëm, duke mos qenë një veprimtari që pikësisht duhet të pasqyrojë standarde të larta turistike dhe të reflektojë politika turistike afatgjata, nga ku natyrshëm derivon edhe përfitimi ekonomik, si për subjektin privat ashtu edhe për bashkinë. Bazuar në evidencat e auditimit, raportet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, si dhe nga auditimet e rregullshme që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer në bashkitë bregdetare, rezulton një bilanc negativ në përmbushjen e kriterëve nga stacionet e plazhit. Kjo shkakton një përplasje me objektin e VKM nr. 369, datë 18.5.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së Stacionit të plazhit” dhe thekson raportin e zhdrejtë mes inkurajimit të masivizimit të plazheve në njërin anë, duke mos pasur në anën tjetër ofertues me “fakultet” turistik për të operuar si stacion plazhi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa për të krijuar një rregullore ose udhëzim mbi profilin turistik që duhet të ketë një stacion plazhi, si dhe të krijojë një bazë të dhënash mbi kategoritë e bizneseve që operojnë si stacione plazhi.

6. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të Ligjit. 10234 datë 18.02.2010 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe”, mungon ngritja e disa instrumenteve për politikën bregdetare në procesin e planifikimit, me qëllim inkurajimin e menaxhimit të integruar të zonave bregdetare, reduktimin e presioneve ekonomike, mirëmbajtjes së zonave të hapura dhe lejitimit të aksesit publik në det dhe përgjatë bregut. Problemi më i theksuar që identifikohet në një format të tillë është mungesa e koordinimit midis autoriteteve të përfshira në çështjet e menaxhimit të plazheve që rezultojnë në një fragmentarizim të rregullave të aplikueshme për një bregdet të vazhdueshëm. Kështu, planet vendore të Bashkisë Durrës, Kavajë apo Rrogozhinë janë të ndryshme për një vijë bregdetare të njëjtë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 1, faqet 14-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në bashkëpunim me bashkitë, të marrë masa për krijimin e strategjive të menaxhimit bregdetar, me qëllim unifikimin e planeve vendore, në rastet kur bashkitë ndajnë të njëjtën tipologji bregdetare.

7. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) gjatë aktivitetit të monitorimit të vijës bregdetare, nëpërmjet degëve rajonale të saj, ka kryer monitorime të vazhdueshme dhe ka konstatuar shkelje të shumta në lidhje me menaxhimin e plazheve dhe ndërhyrjet pa leje në territoret e vijës bregdetare, për të cilat megjithëse vazhdimisht ka njoftuar institucionet kompetente, rezultojnë se ka munguar bashkëpunimi ndërmjet AKB-së dhe këtyre institucioneve (veçanërisht bashkitë që kanë në juridiksion këto territore), për rrjedhojë shumica e shkeljeve të konstatuara dhe të raportuara nuk kanë gjetur zgjidhje, duke e transformuar veprimtarinë e monitorimit të vijës bregdetare, si punë e kryer pa efektivitet dhe pa efikasitet, në mospërputhje me përcaktimet në gjuhën “e” pika 1, kreu III, të VKM-së nr. 31, datë 22.01.2014 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 27-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa në vijimësi, për të rritur shkallën e bashkëpunimit me institucionet e tjera (përgjegjëse për menaxhimin e bregdetit) dhe për çdo rast të konstatuar me shkelje gjatë procesit të monitorimit, për të cilat AKB-ja nuk ka kompetencë për të vepruar, të kërkojë nga institucionet përkatëse kompetente, ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm, deri në eliminimin e plotë të shkeljeve të konstatuara dhe vënien para përgjegjësisë të personave shkelës të ligjit.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka krijuar një regjistër elektronik lidhur me regjistrimin e kontratave që lidhen për përdorimin e plazheve, ndërsa degët rajonale nuk kanë regjistra të rregullt elektronikë dhe nuk kryejnë azhurnimin e vazhdueshëm lidhur me pasqyrimin e të dhënave gjatë monitorimeve që kryejnë, duke mos saktësuar numrin në total të subjekteve që përdorin territoret e plazheve dhe sa nga këto ushtrojnë aktivitetin konform rregullave dhe në përputhje me kriteret ligjore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 27-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me degët rajonale të marrë masa, që çdo degë rajonale të krijojë regjistra elektronikë, për ti azhurnuar ato me të dhëna në vazhdimësi, për çdo monitorim që kryhet, duke ndikuar kështu, në rritjen e cilësisë dhe transparencës së punës së kryer, gjatë monitorimit në terren.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka evidentuar problematika lidhur me ofrimin e standarteve në plazhet publike, veçanërisht konstatimet mbi moszbatimin e kriterëve të lidhura me sigurinë në plazhe dhe infrastrukturën e plazhit publik, *siç janë: tabelizimi i të gjitha hapësirave publike, ku duhet të paraqitet termi “PLAZH PUBLIK”, numrat e emergjencës dhe këshillat për pushuesit, ngritja e pikave të vrojtimit dhe pajisja e hapësirave publike me vrojtues të certifikuar, sigurimi i pastrimit të paktën 2 herë në ditë të hapësirave publike, pajisja e hapësirave publike me shërbime higjienike, markimi i zonës së notimit.*

Përveç sa sipër nuk është bërë evidentimi i saktë i subjekteve që operojnë me kontrata në zonën bregdetare dhe breg liqenore, si dhe markimi i tyre në hartën e përgjithshme të plazheve *Sa sipër bie në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 44-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa në vijimësi, për të rritur shkallën e bashkëpunimit me institucionet e tjera, përgjegjëse për ofrimin e standarteve në plazhet publike, veçanërisht pjesa e kriterëve të lidhura me sigurinë në plazhe dhe infrastrukturën e plazhit publik, dhe për çdo rast të konstatuar me shkelje gjatë procesit të monitorimit, për të cilat AKB-ja nuk ka kompetencë për të vepruar, të kërkojë nga institucionet përkatëse kompetente, ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm, deri në eliminimin e plotë të shkeljeve të konstatuara dhe vënien para përgjegjesisë të personave shkelës të ligjit.

Procesi i lidhjes së kontratave me subjektet që do të operojnë me veprimtarinë e stacionit të plazhit të përfundojë deri në muajin Mars të çdo viti ndaj rekomandohet fillimi i procesit sa më shpejt të jetë e mundur.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analiza e fondeve buxhetore të Agjencisë së Bregdetit dhe MZHETTS , për këtë njësi shpenzuese, rezultoi se fondet janë planifikuar të bollshme dhe të fryra sipas ideve dhe projekteve dhe si rrjedhojë në fakt nuk janë realizuar. Kështu, nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e planifikimit dhe realizimit të buxhetit të viteve 2016 , 2017, 2018 dhe 2019 rezulton se, realizimi i fondeve të alokuara varion nga 45 %-60 %. *Pavarësisht fondeve të bollshme, megjithatë rezulton se fondet për 10 projekte nuk janë realizuar, kryesisht në zërin shpenzime operative për sinjalistikën detare, kullat detare, qendrat e trajnimit, hartimin e rregulloreve etj. Përveç këtyre, ka fonde buxhetore. Të cilat janë paraqitur si realizime të buxhetit në një kohë, që janë likuiduar si detyrime të prapambetura në mospërputhje me ligjin për buxhetin.*

Kjo tregon se AKB nuk i ka parashikuar saktë shpenzimet sipas zërave dhe artikujve, gjë e cila ka ndikuar negativisht në realizimin e objektivave të vëna.

Sa sipër, evidentohet papërgjegjshmëri në planifikimin e fondeve buxhetore dhe përdorim joefektiv të fondeve, si përgjegjësi e nëpunësve autorizues dhe zbatues dhe, në moszbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 19 dhe 20.

Për sa i takon buxhetit vjetor të vitit 2020, konstatohet se AKB nuk ka analizuar sipas zërave, planifikimin i cili duhej të ishte sa me real dhe i realizueshëm, pavarësisht fenomeneve natyrore të ndodhura nga tërmeti si dhe nga pandemia COVID-19 të ndodhura në vitin 2019-2020 e cila ka detyruar që të bëhen ndryshime gjatë vitit ushtrimor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 56-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit Tiranë me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, të hartojnë projekt buxhete PB dhe PBA, duke zbatuar procedurat ligjore, në kohë, mbështetur në plan veprimet dhe dokumente të hartuara me parë, në parashikimin e numrit dhe të kostove të produkteve, pra të bëhet një planifikim real dhe jo i fryrë i buxheteve, në tërësi dhe sipas zërave

dhe artikujve e nën artikujve, me qëllim realizimin e plotë të tyre dhe projekteve e objektivave të vendosura, në mënyrë që mos të krijohet një situatë kontradiktore ku nga njëra anë disponohen fonde të bollshme dhe nga ana tjetër realizimi faktik i buxhetit është më pak se gjysma e fondeve të alokuara.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit Urdhër shpenzimet për të paguar A Sh.A. për shpenzime telefonike te kryera nga punonjësit e agjencisë por që nuk ka dokumente të firmosura nga nëpunësi urdhërues për personat që e përfitojnë këtë të drejtë, urdhër shpenzimet për shpenzime postar nuk kanë dokumentin sipas listës me shkresat e protokolluara për çdo zarf të nisur në postë, Urdhër shpenzimet për shpenzimet për pritje përfaqësuesve të shoqatave të ndryshme për të cilët janë shtruar dreka apo darka, rezulton se bashkëlidhur urdhër shpenzimit nuk ka relacion të hartuar për arritjen e qëllimit të takimeve, ku të pasqyrohet vendi i takimit, numri i pjesëmarrësve dhe personat e tjerë të palës shqiptare në përputhje me detyrën për ndjekjen dhe zbatimin e projektit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 63-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandim: Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit me strukturat përkatëse, njësia e financës të marrë masa të plota për kryerjen e shpenzimeve duke dokumentuar me dokumente autorizuese e vërtetuese në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të Ministrisë së Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit referuar rezultateve të pasqyruara në përmbledhësen e inventarizimit fizik, gjendja fizike e vlerave të aktiveve të pasurisë dhe asetëve të institucionit në datën 31.12. 2017, 2018,2019, e krahasuar me gjendjen e kontabile e pasqyruar në përfundim të periudhës raportuese në pasqyrën financiare datë së fundit të vitit, për llogaritë e inventarizuara, rezulton e barabartë pa diferenca. Në periudhat e audituara, referuar formularit nr. 6 bashkëlidhur pasqyrës financiare konstatohet se njësia shpenzuese nuk ka nxjerrë jashtë përdorimit vlera materiale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 75-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit Tiranë me strukturat përkatëse, Titullari i Institucionit na bashkëpunim me Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, të marrë masa që gjatë kryerjes së proceseve të inventarizimit të krijohen Komisioni për vlerësimin për tu nxjerrë jashtë përdorimit, si dhe komisioni i asgjësimit të materialeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2019 , u konstatua se:

- Zëri “Ndërtesa dhe rikonstrukcione”, llogaria “212” tek aktivi i bilancit formati nr. 1 për vlerën 30,617,417 lekë nuk është i zërthyer në zëra analitik,

- Zëri “Mjete transporti”, llogaria “215” tek aktivi i bilancit formati nr. 1 për vlerën 11,542,974 lekë nuk kuadron me gjendjen e inventarit fizik prej 22, 001,855 lekë, pra diferenca 10,458,881 lekë.

- Llogaria 681 “Amortizimi” i akumuluari mjeteve kryesore nuk është pasqyruar në bilanc, ndërsa është pasqyruar tek formati 7/b i bilancit për vlerën 18,221,639 lekë.

- Amortizimi i inventarit ekonomik është pasqyruar tek formati 2 “pasqyra performancës financiare” për 245,108 lekë, por nuk kuadron me pasqyrën analitike sipas zërave të tij.

- Mungon relacioni i bilancit 2019, për sqarimin e pozicionit të llogarive vjetore.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, ligjin nr. 25/2018 date 10/05/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,me VKM 248, datë

10.04.1998 me UMF 37 date 19.12.2019 “Per procedurat e mbylljes Llogarive vjetore te buxhetit te vitit 2019”

Nga auditimi i inventarizimit fizik për vitin 2020 të AKB Tiranë, u konstatua se: mungon procesverbali i komisionit të inventarizimit fizik të pasurisë të AKB dhe nuk ka relacion për sistemimin e diferencave, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë sektorit publik,” dhe ligjin nr. 10296 date 10.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 75-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandim: AKB Tiranë, sektori i financës:

a. Në mbylljen e bilancit 2021 të sistemojve disa llogari të bilancit 2019, pasi ato mbarten në vitin pasardhës, konkretisht:

- të azhurnojë në zëra analitik llogarinë 212 “Ndërtesa rikonstrukcione” për 30,617,417 lekë,
- të kuadrojë llogarinë 215 “Mjete transporti”, pasi nuk kuadron vlera kontabël 11,542,974 lekë me vlerën e inventarit fizik 22,001,855 lekë, për diferencën 10,458,881 lekë,
- të sistemojë llogarinë 681 “Amortizimi” i akumuluarit mjeteve kryesore, pasi nuk është pasqyruar në bilancin 2019.
- të sqarojë gjendjen dhe pozicionin e llogarive vjetore nëpërmjet relacionit të bilancit 2021.

b. Të kryej inventarizimit fizik të pasurisë për vitin ushtrimor, pasi nuk është kryer për vitin 2019.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me respektimin e strukturave organike, plotësimin e tyre në AKB Tiranë u konstatua se nga ky institucion që nga vitit 2016 dhe deri në fund të vitit 2019 nuk rezulton të jetë plotësuar struktura dhe organika sipas numrit të punonjësve të strukturës, e ndarë sipas viteve rezultojnë: për vitin 2016 e pa plotësuar organika për 6 punonjës, për vitin 2017 e pa plotësuar për 17 punonjës, për vitin 2018 rezulton e pa plotësuar për 14 punonjës dhe për vitin 2019 rezulton e pa plotësuar për 9 punonjës. Gjithashtu nuk ka funksionuar struktura e Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit Territorial të Zonave Bregdetare, e cila ka mbetur vakant për 6 vite deri në 2020, duke mos u plotësuar me Drejtor, përgjegjës sektori dhe specialistë, Drejtorja e Legjislacionit dhe Monitorimit, që prej vitit 2016 nuk është plotësuar me Drejtor dhe në përbërje të saj vepron vetëm një specialiste/juriste. Këto vakanca e kanë penguar këtë institucion që të ushtrijë në mënyrë të plotë funksionet, duke krijuar mangësi në lidhje me organizimin dhe shfrytëzimin e kapaciteteve dhe pamundësi për të kryer një monitorim sa më efikas të vijës bregdetare.

Janë konstatuar mangësi dhe mosplotësime të strukturës organike të trashëguara nga periudhat e mëparshme vitet 2016-2019, ku evidentohen lëvizjet largimet e punonjësve me vjetërsi shërbimi, por edhe nga ndryshimet strukturore për shkak të ristrukturimit me gjithë përmirësimet në plotësim kryesisht në vitet 2019-2020 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 75-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandim: AKB, Sektori i Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe me DAP, të marrin masa për plotësimin e strukturave të miratuara me numrin e caktuar të punonjësve në përputhje me kriteret profesionale të vendeve të punës, me synim eliminimin e vendeve vakantë të punonjësve me status nëpunës civil dhe punonjësve të shërbimit mbështetës, sikundër pasqyruar në tabelën “Plotësimi i Strukturës dhe vakancat në AKB për v.2020”.

Brenda muajit Dhjetor 2021.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me pagat, rezultojnë të jenë kryer pagesa të punonjësve me kontratë për 10 studentë ekselencë të punësuar në zbatim të VKM nr. 766, datë 26.12.2018, dhe VKM nr. 586, datë 30.08.2019 në pozicionet vakant të

kategorisë ekzekutive (specialist dhe të barasvlershëm) në institucionet pjesë e shërbimit civil me prioritet të diplomuar që nga viti 2017 duke lidhur kontratë të përkohshme 1 vjeçare dhe sipas listës dërguar nga DAP pikat 1, 12-13 dhe pikat 2, 12, 13 dhe 14 të VKM nr. 586, datë 30.08.2019.

Sa sipër, rezulton të jenë kryer pagesa me kategorinë IV-a dhe jo sipas kategorisë IV-b, bazuar në VKM dhe lidhjen 1, me shtese pozicioni 38,000 lekë në zbatim të tabelës pagave lidhja 1, nënlidhja 6 me një diferencë 11,000 lekë të kategorisë IV-a me IV-b dhe nuk është marrë parasysh fakti që gjatë punësimit me kontratë të përkohshme duhet të ishte zbatuar pika 4-5 e VKM nr. 16, datë 16.01.2019, dhe në vijim pika 5, VKM nr. 47, datë 22.01.2020, për strukturën e miratuar për vitin 2020, sipas së cilës punonjësit me kontratë në funksion specialist paguhen në përputhje me kategorinë e pagës së funksionit të ngjashëm organik, përcaktuar në strukturën e Institucionit, por në asnjë rast kategoria e pagës në institucionet në varësi të institucioneve qendrore nuk duhet të kalojë Nivelin IV-b, sikurse evidentohet AKB si institucion e në varësi të organit qendror, Ministrinë të Linjës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 75-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandim: AKB Tiranë, bazuar në shkeljet e konstatuara në lidhje me pagesat e kryera për punësimin e 10 studenteve ekselence me kontratë të përkohshme për strukturën e miratuar për vitin 2020, kryer pagesa të tepërta si diferencë ndërmjet kategorive në vlerën 11000 lekë, të marrë masa për përcaktimin e detyrimeve dhe arkëtimin e tyre, duke kërkuar më parë nga DAP, Ministria e linjës, Ministria e Financave, interpretimin e pikave 4-5 të VKM nr. 16, datë 16.01.2019, dhe të pikës 5, të VKM nr. 47, datë 22.01.2020, për strukturën e miratuar për vitin 2020, që sipas së cilës punonjësit me kontratë në funksion specialist paguhen në përputhje me kategorinë e pagës së funksionit të ngjashëm organik.

Brenda muajit Dhjetor 2021

16. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2015-2020, gjendja në formim dhe ristrukturim e AKB ka sjellë lëvizje të shpeshta pranim-largimi të punonjësve në raportet 45:25 ose me koeficient 55,5%, ku më të dukshme janë largimet në vitet 2016-2019 të punonjësve me vjetërsi, ndërsa pranimet evidentohen kryesisht në vitin 2019-2020. Konkretisht në AKB Qendër janë larguar 25 punonjës me kohëzgjatje mesatare të marrëdhënies punës 3 vjet e 3 muaj dhe 11 punonjës nga Agjencitë (Degët) me kohëzgjatje deri 2 vjet. Ndërsa 45 pranimet e reja, ndarë 30 pranime në Qendër nga të cilat 22 në v.2020, zotërojnë eksperiencë deri 1 vit, kurse 15 pranime në Degët Rajonale prej tyre 6 pranime në v.2020, me eksperiencë pune mbi 2,5 vjet, Situata e pranim largimeve të shpeshta të punonjësve gjatë viteve 2015-2019 ka sjellë pamjaftueshmëri në eksperiencë, eliminimi i së cilës do të sillte stabilizim e qëndrueshmëri të punësuarve dhe rritjen e shkallës së menaxhimit, në funksion të treguesve të përmbushjes së detyrave, si dhe parashikime në rritje të objektivave megjithë masat e mara përmirësuese gjatë fund vitit 2019 dhe v.2020, periudhë e cila ka qenë e ngarkuar edhe me problematikat e fatkeqësisë tërmeti dhe pandemia, sikundër trajtuar në tabelën emërtuar: "Pranim-Largimet dhe Kohëzgjatja e Marrëdhënies së Punës 2015-2020".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 75-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa lidhur me menaxhimin e personelit, të analizojë pranim largimet e të punësuarve duke nxjerre shkaqet dhe faktorët negativ që kanë sjellë koeficientin e lartë të ndërprerjeve të marrëdhënies së punës me pasoja negative, si dhe të hartojnë e zbatojnë programe trajnimi e specializimi nën asistencën e eksperiencave brenda e jashtë vendit.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit me objekt: Me negociim pa shpallje, me objekt: "Ndërtimi i kullave vrojtuese"; "Sinjalistika e infrastrukturës turistike midis zonave

bregdetare dhe malore"" , me vlerë të fondit limit 9,616,666 lekë; "Rijetëzimi i qendrës së fshatit Nivicë", me vlerë të fondit limit 42,489,769 lekë dhe "Ndërtimi i kullave vrojtuese", me vlerë të fondit limit 4,156,252 lekë, janë konstatuar devijime nga kriteret që rregullojnë procedurat e prokurimit, s`kualifikime të padrejta të pjesëmarrësve në prokurime, mosargumentim i fondit limit, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenet 28, 53, 58, pika 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, pika 2 neni 59, 66, e VKM nr. 914 ,datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015 dhe vendimin nr. 823, datë 23.11.2016.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, AKB të marrë masa dhe të ndjekë me rigorozitet kryerjen e të gjithë procedurave në prokurimin e fondeve publike, vecanërisht lidhur me kriteret që rregullojnë procedurat e prokurimit, për konfiskimin e sigurimit të ofertës, s`kualifikimet e pjesëmarrësve në prokurime për deviacione të vogla, mosargumentim i fondit limit, etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit me objekt: "Rijetëzimi i qendrës së fshatit Nivicë", "Ndërtimi i kullave vrojtuese", "Hartimi i rregulloreve për administrimin e hapësirave publike të zonave bregdetare dhe planifikimi i tyre" dhe "Rikonstruksioni i shkollës së vjetër Nivicë": rezultoi se në hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim në procedurat e prokurimit nuk kanë gjetur zbatim aktet ligjore e nënligjore të fushës së prokurimit publik, duke mos i argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës (në drejtim të numrit të punonjësve dhe stafit drejtues, mjeteve, numrit të tyre dhe specifikimeve teknike, si dhe kriterëve të veçanta lidhur me kategori të caktuara të kërkuara), çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal. "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike" dhe VKM nr. 914 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku citohet "Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve", "Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: licence profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekti kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore". në kundërshtim me nenin 26, pika 5, nenin 61, pika 2, paragraf i të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" *(Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 7, faqet 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, AKB, të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim të argumentuara dhe në lidhje të ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit, të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave me vlerë të vogël për periudhën objekt auditimi, gjatë auditimit të procedurave në 12 raste u konstatua: Përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk ka përlllogaritur fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që ka prokuruar, nuk ka hartuar raportet dhe të gjithë dokumentacionin përkatës të prokurimeve.

Nuk është përcaktuar saktë baza ligjore e urdhrave të prokurimit. Dokumentacioni i operatorëve ekonomikë nuk ka qenë i plotë dhe i saktë në dosjen përkatëse.

Nuk është përgatitur rregullorja funksionale dhe regjistri i riskut për këtë sektor.

Veprimet e më sipërme janë në pajtueshmëri me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), VKM nr. 918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” si dhe Udhëzimi nr. 3, dt.27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, dt.21.04.2016, Udhëzimi nr. 2, dt.27.01.2015 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve dhe të realizimeve të prokurimit publik” si dhe udhëzime të tjera të Agjencisë të Prokurimit Publik (*Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 7, faqet 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Rekomandim: Nga AKB, për përmirësimin e punës në të ardhmen të merren masa që të plotësohen dosjet me të gjitha dokumentet e munguara si edhe kopje të mesazhit elektronik ose njoftimi zyrtar për shoqërinë e s'kualifikuar.

Të kryhet hartimi i raporteve dhe të gjithë dokumentacionin përkatës të prokurimeve.

Të bëhet llogaritja/rillogaritja e fondit limit duke qenë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e institucioneve përkatëse.

Të përcaktohet e saktë baza ligjore e urdhrave të prokurimit. Dokumentacioni i operatorëve ekonomikë të jetë i plotë dhe i saktë në dosjen përkatëse.

Të përgatiten dhe miratohen rregullorja funksionale dhe regjistri i riskut për këtë sektor.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste, gjatë zbatimit të kontratave për punë publike, për objektet: “Rikonstruksion i ish Shkollës së vjetër Nivicë” dhe “Sinjalistikë e Infrastrukturës turistike midis zonave bregdetare dhe malore”, rezulton se nga mbikëqyrësit e punimeve të kontraktuar nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, nuk janë marrë masa për të kontrolluar plotësimin e kërkesave dhe kushtet kontraktuale, lidhur plotësimin e dokumentacionit që argumenton arritjen e cilësisë së kërkuar për punimet e kryera, në përputhje me standardet dhe kërkesat e specifikimeve teknike, pasi rezulton se janë vendosur në objekt, disa materiale ndërtimi, që nuk janë shoqëruar me certifikata cilësie, apo raporte testimi, veprime këto në kundërshtim me nenin 14, të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe me kushtet e kontratës përkatëse (*Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 7, faqet 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit për kontratat e punimeve që do të lidhen në vijim të kërkojë mbikëqyrësve dhe operatorëve ekonomikë të kontraktuar plotësimin e dosjes me dokumentacionin teknik ligjor të munguar, që vërteton cilësinë e materialeve të vendosura në objekt, në të kundërt kundrejt kontraktorit, të aplikohen masa penalizuese sipas përcaktimeve ligjore e kontraktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit si Autoritet Kontraktor, pasi përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve, ka marrë në dorëzim objektin e përfunduar “Rijetëzimi i Qendrës së Fshatit Nivicë” dhe objektin “Rikonstruksion i ish Shkollës së vjetër Nivicë”, por nuk i ka kërkuar Bashkisë Tepelenë (e cila ka në administrim këto pasuri) dhe nuk i ka dërguar dokumentacionin përkatës, për të bërë të mundur kontabilizimin e vlerës së investimit të kryer dhe rivlerësimin e sheshit dhe objekteve në pronësi “shtet”, sipas vlerës së marrë nga investimi i kryer, përkatësisht: Qendra e Fshatit Nivicë në vlerën 38,661,024 lekë (me TVSH) dhe shkolla e Vjetër Nivicë në vlerën 4,753,284 lekë (me TVSH).

(*Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 7, faqet 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa, ti dërgojë Bashkisë Tepelenë dokumentacionin përkatës të investimit të kryer në objektet “Rijetëzimi i Qendrës së Fshatit Nivicë” dhe “Rikonstruksion i ish Shkollës së vjetër Nivicë”, duke i kërkuar kontabilizimin e vlerës së investimit të kryer, si dhe ti kërkojë që të aplikojë pranë Drejtorisë Vendore të Kadastrës Tepelenë, për të bërë rivlerësimin e objekteve ndërtesa në pronësi “shtet”, sipas vlerës së marrë nga investimi i kryer, përkatësisht: Qendra e Fshatit Nivicë në vlerën 38,661,024 lekë(me TVSH) dhe shkolla e Vjetër Nivicë në vlerën 4,753,284 lekë.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për periudhën audituese, nuk ka përthithur fonde nga projektet IPA në vlerë 356,698 euro, për shkak të dy faktorëve (i) së pari mungesa e kapaciteteve njerëzore në AKB për implementimin e projekteve IPA (janë kontraktuar ekspertë të jashtëm) dhe (ii) nga përfshirja në 4 projekte me afat zbatimi dhe përfundimit në të njëjtën kohë. Projektet financohet në kuadër të Ligjit Nr.138/2016, datë 22.12.2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Itali –Shqipëri-Mali i Zi, 2014-2020”. Për projektet e IPA, AKB nuk ka realizuar plotësisht aktivitetet e përcaktuara në formularin e aplikimit si dhe nuk ka dorëzuar raportimet e shpenzimeve tek partneri drejtues i projekteve IPA, brenda afateve të përcaktuara sipas buxheteve përkatëse të shpenzimeve në kundërshtim me marrëveshjet e financimit dhe partneritetit. Në kundërshtim me VKM-në Nr.541, datë 18.6.2015 “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit evropian, në kuadër të instrumentit të asistencës së para-anëtarësimit IPA II (2014 – 2020) konstatohet nivel i dobët i bashkëpunimit dhe rakordimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar të IPA II, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet 145-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që, për aplikimet në projektet IPA, të informojë paraprakisht Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar të IPA II dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues, duke marrë paraprakisht miratimin nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si organ epror për projektet potenciale ku synon të aplikojë.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha rastet për projektet IPA, Agjencia Kombëtare e Bregdetit nuk i ka parashikuar kostot lokale në planifikimin e buxhetit afatmesëm sipas përcaktimit të Udhëzimit Nr. 10, datë 09.03.2015 “Për përcaktimin e procedurave për menaxhimin nëpërmjet Fondit Kombëtar të bashkëfinancimit të buxhetit të shtetit për projektet IPA”, pika I.1 si dhe është konstatuar çelja me shumë vonesë e formularit të identifikimit financiar (FIF). Të përcaktohen kriteret teknike dhe nevoja për specialistë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet 145-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që të parashikojë në programin buxhetor afatmesëm fondet përkatëse për projektet IPA si dhe të planifikojë për çdo vit, projektet potenciale IPA ku synon të aplikojë, për të cilën të marrë miratimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si organin epror dhe të rakordojë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të përshpejtuar procesin e hapjes së kodit të investimit të projektit (FIF), me qëllim shmangien e vonesave të cilat kanë ndikuar në uljen e nivelit të përthithjes së fondeve IPA.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Për tenderimin e shërbimit të ekspertizës së jashtme në projektin “Ëelcome” në vitin 2019, me vlerë 22,000 euro është ndjekur procedura “e kufizuar”(restricted) në kundërshtim me pikën 3.3.2 të rregullave të PRAG-ut (Guida praktike për procedurat kontraktues të jashtme të BE-së) pasi është procedurë që ndiqet për kontrata me vlerë mbi 300,000 euro. Për kontratat e shërbimit mbi 20,000 euro dhe nën 300,000 euro ndiqet procedura “ e thjeshtuar” (“simplified”).

Në po në njëjtën datë, 19.02.2019 kur është shpallur njoftimi i kontratës, që supozon pritjen e ofertave, u është dërguar ftesa nominalisht tre subjekteve. Për rrjedhojë, edhe “procedura e kufizuar” e zgjedhur gabim nuk është zbatuar në përputhje me PRAG, pasi kërkohet të hartohet fillimisht një “Long List” apo “Lista e Gjatë” e të gjithë atyre kandidatëve që i përgjigjen njoftimit dhe më pas shkurtet në një listë të shkurtër të atyre që janë më të kualifikuar bazuar në kriteret e përzgjedhura, sipas procedurave të pikës 2.6.3 të PRAG (hartimi i listës së shkurtër në procedurën e kufizuar). Në zërat e shpenzimeve për ekspert të jashtëm, për vlerën totale prej 10,000 euro përcaktohet thjesht një ekspertizë për kornizën ligjore dhe për vlerën 12,000 euro përcaktohet thjesht ekspert i jashtëm që do të kontribuojë për planin e menaxhimit të zonave bregdetare në Shqipëri, ndërsa nga AKB është realizuar për dy produkte të ndryshme një tender i vetëm për ekspertizë të jashtme (*Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 8, faqet 145-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për çdo njoftim kontrate, të marrë masa për ta botuar shpalljen e kontratës, si dhe në të gjitha rastet kur duhet të ndjekë “procedurën e thjeshtuar” (simplified) të hartojë një raport mbi studimin e tregut për kandidatët e përzgjedhur dhe t'i shoqërojë me arsyet e përzgjedhjes së tyre, sipas rekomandimeve të dokumenteve standarde të PRAG-ut.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për projektin “Welcome” me vlerë 22,000 euro, ka bërë pagesa në shumën 19,620 euro përmes urdhrave të transfertës bankare, përkatësisht të datës 13.12.2019 dhe 27.12.2017 për operatorin fitues, pa u përfunduar output-et e kërkuara sipas termave të referencës për kontratat e llojit “global price”, ku përcaktohet se kontraktuesi paguhet vetëm pasi të jetë përfunduar output/et apo produktet e parashikuara sipas dorëzimit të disa raporteve. Në kontratën me nr. 30/7 Prot, datë 13.05.2019 raportet fillestare të ndërmjetme dhe finale nuk janë përcaktuar në termat e referencës, konkretisht ANNEX II: “Termet e Referencës”, Pika 7 “Raportet” si dhe me nenin 26 dhe nenin 27 “Miratimi i raporteve dhe dokumenteve” të dokumentit standard “Kontrata” ku përcaktohet se “Kontraktori duhet të dorëzojë raportin fillestar, të ndërmjetëm dhe final, sikurse përcaktohet në termat e referencës” si dhe me Manualin e Prokurimit të Projektit IPA.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 8, faqet 145-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

25.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për çdo rast për kontrata të llojit “global price” të përcaktojë në mënyrë të qartë në termat e referencës çfarë produktesh duhet të ofrojë operatori fitues, duke bërë shpërndarjen e kësteve të pagesave, sipas përcaktimeve të dokumentit standard “Kontrata” të PRAG-ut, brenda afateve dhe formateve të caktuara me indikatorë të matshëm.

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast, në hartimin e specifikimeve për kualifikimet dhe aftësitë e ekspertëve të jashtme për projektet IPA, nuk janë zbatuar rekomandimet e PRAG-ut, Pika 6, “Kriteret” të Dokumentit Standard mbi hartimin e specifikimeve teknike. Konkretisht rregullat e Komisionit Evropian kërkojnë që të mos përcaktohet kritere për kontraktimin e një “eksperti ideal” pasi kjo do të kufizonte ofertat, por sugjerojnë që të përshihen formulime si “preferohet

10 vite eksperiencë por minimumi i kërkuar është 5 vite”. Në rastin konkret, në termat e referencës është vendosur se ofertuesi duhet të ketë “të paktën 10 vite pune eksperiencë në fushën e studimeve mjedisore”. Për pasojë, ky kriter e ka kufizuar konkurrencën e ofertuesve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 8, faqet 145-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, gjatë hartimit të specifikime teknike, t'i formulojë kriteret kualifikuese në mënyrë të atillë që të zgjerojë rrethin e ofertuesve dhe jo duke përcaktuar kriteret kufizuese, por të marrë në konsideratë kërkesat minimale që ofron tregu shqiptar i ekspertëve mjedisorë.

Në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Në tenderin për ekspertizë të jashtme me vlerë 21,070 euro, viti 2019, për Projektin “Reglport” “Procedurë e thjeshtuar”(simplified procedure), procedura tenderuese është sipas përcaktimeve të PRAG. Për rrjedhojë, rezulton se kanë aplikuar persona juridikë ndërsa kualifikimet dhe aftësitë në termat e referencës janë formuluar për personat fizikë në kundërshtim me pikën 61.1 “Ekspertët kyç”. Në Dokumenti Standard i PRAG-ut, në termat e referencës së AKB nuk janë parashikuar numri i ekspertëve që do të ofrojë kontraktuesi dhe cilat do të jenë profilet e tyre. Në dokumentin vërtetues mbi personelin, në stafin permanent të dorëzuar nga ofertuesi fitues paraqitet vetëm 1(një) numri i stafit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 8, faqet 145-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, gjatë hartimit të referencave, të veçojë kriteret kualifikuese për personat juridikë dhe personat fizikë. Në rast kur përcakton vetëm për persona juridikë, të përcaktojë qartë numrin e ekspertëve të kërkuar dhe kualifikimin për secilin.

Në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Në procedurën tenderuese të kontratës së shërbimit për ekspert të jashtëm në projektin “Blue Cost” me vlerë 9,100 euro, procedura e përzgjedhur nuk është sipas rregullave të PRAG, konkretisht për prokurimet me vlerë më të vogël se 20,000 euro, procedura duhet të ishte me “negocim” ose tenderues i vetëm (single tenderer). Është konstatuar se “eksperti kyç”, (Instituti Shqiptar për Zhvillim Social& Ekonomik) ka fituar njëkohësisht edhe një tender për ekspertizë të jashtme në kuadër të projektit “Reglport” Interreg IPA në kundërshtim me rregullat e Komisionit Evropian, konkretisht, me kërkesat e Deklaratës së Tenderuesit për Ekskluzivitetin dhe Disponueshmërinë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Dokumentin standard të PRAG “Instruksione të Tenderuesit” pika 4.1 “Oferta Teknike” si dhe me Deklaratën e Tenderuesit. Në këtë rast, AKB duhet të kishte refuzuar nënshkrimin e kontratës dhe anuluar tenderin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 8, faqet 145-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të refuzojë ata ekspertë nga procedura tenderuese në rastet kur janë shpallur fitues për një kontratë tjetër, afati i zbatimit të të cilit është i njëkohshëm me kontratën e parë që është shpallur fitues.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të kontratës së shërbimit me objekt “Vlerësimi shëndetësori stacioneve monitoruese” me vlerë 3,500 euro, procedura e thjeshtuar tenderuese nuk është zbatuar në përputhje me rregullat. Sipas PRAG, duke qenë se po tenderohet një shumë më e vogël se 20,000 euro, procedura tenderuese duhet të ishte single tender. Së pari nuk janë përzgjedhur tre kandidatë të cilëve u duhej dërguar ftesë për ofertë, por kanë ardhur tre oferta nga tre persona juridikë të natyrës së Organizatave Jo Fitimprurëse, bazuar në thirrjen që është bërë në datën 12.12.2019. Konkretisht, në nenin 3 të fushës së veprimtarisë së Statutit të themelimit, përcaktohen fusha si “arsimi, çështje ekonomike, afirmuar kode dhe standarde në lidhje me përgjegjshmërinë e bizneseve dhe zbatimin e teknologjive të reja në praktikën e

marketingut”. Po ashtu, është tenderuar për një objekt të pa identifikueshëm, pasi Agjencia Kombëtare e Bregdetit nuk ka informacion se ku ndodhet stacionet e breshkës carreta në bregdetin shqiptar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 8, faqet 145-163, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

29.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë në analizë procedurën e tenderit me objekt “Vlerësimi shëndetësor i stacioneve monitoruese” dhe të nxjerri përgjegjësit e personave përkatës, për mënyrën e zgjedhjes së llojit të procedurës së tenderimit.

Në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Për ngritjen dhe konsolidimin e strukturës së Inspektoratit, pas nisjes së veprimtarisë inspektuese në AKB, Drejtori i Përgjithshëm i AKB, me shkresën nr.1773, datë 25.9.2020 ka kërkuar dhe propozuar pranë MTM, bashkëlidhur projekt-vendimin përkatës, për ngritjen, krijimin dhe miratimin e strukturës së Komisionit të Ankimit pranë AKB; për të cilën nga MTM ende nuk ka përgjigje; kjo në mosplotësim të nenit 51 “Ankimi ndaj Vendimit Përfundimtar të Inspektimit” pikat 2, 3, të ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” ku shprehet: “Organizimi i Organit epror sipas pikës 2 të këtij neni përcaktohet nga KM”, të Ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin” neni 17 “Funksionet dhe Kompetencat e Inspektoratit të Turizmit”, pika 4 si dhe të VKM nr. 569, datë 17.07.2019, kapitulli III-të, pika 6, germa “i” ku shprehet: “...Shqyrton ankesat për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve...”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqet 165-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1 Rekomandim: AKB të ri kërkojë pranë MTM vazhdimin dhe ecurinë e plotësimit të kësaj strukture me synim, realizimin final të përmbushjes së procedurave të inspektimit, për praktikën e ndodhura në proces ankimit.

Brenda muajit Dhjetor 2021

31. Gjetje nga auditimi: Lidhur me ekzekutimin e masave administrative, mos dokumentimin identifikimin, shqyrtimi në ndonjë ankese, rezultoi mos arkëtimi i 18 gjobave të vendosura me vlerën 3,310, 000 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 10279 “Për Kundërvajtjet Administrative” si pasojë e mos ngritjes e funksionimit të Komisionit përkatës (trajtuar më sipër).

Për gjobat e pa ankimuar ngarkohen me përgjegjësi strukturat përkatëse të AKB.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqet 165-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1 Rekomandim: AKB, strukturat përkatëse (DSZHQTZB, Sektori Juridik dhe Financës) të marrin masa për ndjekjen e hapave ligjor për arkëtimin e gjobave të vendosura nga inspektimet gjatë vitit 2020 ndaj subjekteve me veprimtari në kundërshtim me ligjin.

Brenda muajit Dhjetor 2021

32. Gjetje nga auditimi: AKB, sektori i inspektim-monitorimeve për vitin 2020 ka kryer monitorime-verifikime në 300 subjekte me veprimtari stacione plazhi lidhur me respektimin e masave anti COVID dhe zbatimin e kriterëve ligjorë për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi nga ku rezultoi se një pjesë e konsiderueshme nuk plotësonin, kushtet apo kriteret sikundër pasqyruar në tabelën emërtuar “Tabela e monitorimeve në Stacione plazhi për kriteret e funksionimit dhe për masat anti COVID v.2020 “; kjo në mos përmbushje të VKM nr. 171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” dhe të VKM nr. 424 datë 27.05.2020 2020 “Për një shtesë në vendimin nr. 171, datë 27.03.2019”. Për këtë AKB ka njoftuar me shkresa datë 29.07.2020 gjendjen dhe kërkuar bashkëpunim ndaj 8 Bashkive (Himarë, Shkodër, Kavajë, Sarandë, Pogradec, Durrës, Rrogozhinë dhe Divjakë) për të cilat këto Bashki nuk kanë kthyer përgjigje për masat e marra duke treguar mungesë niveli bashkëpunimi, mosveprim në kundërshtim me VKM nr. 569, datë

17.07.2019, “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, kreu i III-të, pika 6, germa përkatëse.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqet 165-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.1.Rekomandim: AKB të marrë masa duke ri kërkuar tek bashkitë që nuk kanë kthyer përgjigje për njoftimet në lidhje me subjektet që janë identifikuar në mosplotësim të kriterëve ligjore për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi dhe mosplotësim të marrjes së masave anti COVID , si dhe duke i përfshirë në programet e inspektimeve dhe monitorimeve sipas shkallës së riskut në programet përkatëse periodike; me synim mbështetjen e subjekteve me veprimtari turistike në drejtim të përmirësimit të standardeve dhe shërbimit turistik dhe rritjen e shkallës së bashkëpunimit me NJVV-të dhe Organet e tjera.

Në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Nga monitorimi i 1797 subjekteve sipas listës vënë në dispozicion nga Ministria për verifikim, struktura akomoduese (hotele) të shtrira në gjithë territorin, lidhur me pajisjen me certifikatë kategorizimi, rezulton se vetëm 366 subjekte mbanin certifikatën e kategorizimit, dhe pas përfundimit të procesit të monitorimit 154 subjekte aplikuan pranë MTM-së, 338 subjekte u futën në procedurën e plotësimit të dokumentacionit për aplikim, 161 subjekte ishin evidentuar gabimisht si subjekte akomoduese, kur në fakt ushtonin veprimtari të tjera (markete, bare, etj), 148 subjekte shfaqën se nuk ushtrojnë aktivitet akomodues për shkak të ndryshimit NIPTi, çregjistrimi në QKB, transferimi aktiviteti etj; kjo në mos përbushje të VKM nr.730, datë 20.10.2016 “Për Miratimin e Rregullores, për Kushtet, Kriteret, Tarifat, Afatet dhe Procedurën për Klasifikimin e Strukturave Akomoduese” dhe të Urdhrit nr. 267, datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar.

Për këtë në përfundim të misionit të monitorimit sipas urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 50, datë 11.09.2020, AKB ka raportuar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, lidhur me procesin e verifikimit të strukturave akomoduese me shkresën nr.1995, datë 30.12.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqet 165-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1 Rekomandim: AKB të ndjekë monitorimet duke i përfshirë në planet përkatëse monitorim inspektim, të raportoje në Ministri dhe të bashkëpunojë me strukturat e tjera si NJVV-të për identifikimin dhe formalizimin e pajisjes me certifikatë të subjekteve, strukturave akomoduese ekzistuese dhe të reja që krijohen rishtas.

Në vijimësi

D. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i AKB, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **1,284,265 lekë**. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 1,284,265 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të bankës për vitin 2020, u konstatuan disa mangësi dhe shkelje me efekte financiare për vlerën 48,325 lekë, konkretisht:

- *Shpenzime për gjoba* për vlerën **2,000 lekë**, për tejkalim afati të kontrollit vjetor teknik të automjeteve me targa AA763NY dhe AA590PK, pasi kanë lejuar likuidimin nga fondet e AKB,

në vend të personave fajtor që nuk kanë respektuar afatet ligjore të kolaudimit mjeteve, sipas urdhër shpenzimeve nr. 23, datë 06.02.2020 dhe nr. 86, datë 09.03.2020.

- **Shpenzime për blerje me vlera vogla** për vlerën **46,325 lekë**, përkatësisht:

* *vlera 24,960 lekë TVSH*, për subjektin “B C” shpk, sipas urdhër shpenzimit nr. 212, datë 11.08.2020, shpenzime figuracioni TPL për 6 automjetet e institucionit, pasi fatura e subjektit nr. 6, datë 03.08.2020 është e parregullt dhe jo e modelit tatimor, sepse subjekti është person juridik dhe jo person fizik, çka ka krijuar evazion fiskal për vlerën 24,960 lekë me TVSH. Gjithashtu subjekti “B C” shpk nuk është kompani sigurimesh por agjenci turistike, sipas QKB, madje 6 siguracionet ose TPL e automjeteve janë lëshuar nga një kompani tjetër sigurimesh “E” shpk, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” i ndryshuar, me pikën 52 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar kreun VI pika 2/ç, me VKM nr. 1149, datë 25.11.2009 “Për shtypin dhe shpërndarjen e dokumentit tatimor”.

* *vlera 21,365 lekë dëm ekonomik*, diferencë çmimesh nga tregu për shpenzime mirëmbajtje 6 printer zyresh, sipas urdhër shpenzimit nr. 342, datë 23.11.2020, konkretisht:

riparim 1 printeri OKI” për 18,000 lekë nga 13,020 lekë vlera fillestare, diferenca 4,980 lekë.

riparim 1 printeri “OKI” për 18,000 lekë nga 15,622 lekë vlera fillestare, diferenca 2,375 lekë.

riparim 1 printeri “Kiocera” për 21,600 lekë nga 7,590 lekë vlera fillestare, diferenca 14,010 lekë.

Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, me UMF nr. 33, datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.06.2014 “Për gjurmët standarde auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe- ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 63-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandim: AKB Tiranë, sektori i financës të marrë masat ligjore për arkëtimin e vlerës **48,325 lekë**, përfituar padrejtësisht nga punonjës dhe subjekte, si shpenzime të kryera nëpërmjet bankës në vitin 2020, pa mbështetje ligjore dhe të pa justifikuar me dokumente, konkretisht:

- vlera **2,000 lekë**, për gjorbë tejkalim afati të kontrollit teknik të automjeteve me targa AA763NY dhe AA590PK nga drejtuesit e mjeteve me nga *1,000 lekë/secili*.

- vlera **24,960 lekë TVSH**, nga subjekti “B C” shpk, pasi fatura e subjektit nr. 6, datë 03.08.2020 është e parregullt dhe jo e modelit tatimor, sepse subjekti është person juridik dhe jo person fizik, çka ka krijuar evazion fiskal, sipas urdhër shpenzimit nr. 212, datë 11.08.2020, shpenzime siguracioni TPL për 6 automjetet e institucionit.

- vlera **21,365 lekë**, diferencë çmimesh për shpenzime mirëmbajtje printer zyresh, sipas urdhër shpenzimit nr. 342, datë 23.11.2020, nga komisioni i blerjeve vogla E D, A Z, G T dhe financa M T me nga *5,341 lekë/secili*.

Brenda muajit Dhjetor 2021

2. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **310,440 lekë** ndaj operatorit ekonomik “E C C” shpk, në situacionimin e volumeve të punimeve për 5 zëra punimesh, konkretisht: *Fugatim i mureve dhe Mbushje ngjeshje me gurë kave*, etj, me diferenca volumesh të pa kryera, por të likuiduara, në objektin “Rijetëzimi i Qendrës së Fshatit Nivicë”, me vlerë të kontratës **42,295,686 lekë me TVSH**, në kundërshtim me pikën 3.2 dhe pikën 3.3, të UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr. 3, datë 15.02.2001” dhe kushtet e kontratës nr. 689/3, datë 01.11.2016. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa e të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **310,440lekë**, nga operatori ekonomik “E C C” sh.p.k., paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Rijetëzimi i Qendrës së Fshatit Nivicë”, Bashkia Tepelenë.

Brenda muajit Dhjetor 2021

3. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, ka kryer pagesa të tepërta në vlerën, **595,300 lekë** ndaj operatorit ekonomik “C” shpk, në situacionimin e volumeve të punimeve për 3 zëra punimesh konkretisht: *Murë me tulla të veçanta, oxhak deri 50 m, Veshje fasade me pllakë guri, Brez b/a C 16/20, h~8 m*, me diferenca volumesh të pa kryera, në objektin “Rikonstruksion i ish Shkollës së vjetër Nivicë”, me vlerë të kontratës 4,753,284 lekë me TVSH, në kundërshtim me pikën 3.2 dhe pikën 3.3, të UKM nr. 1, datë 16.06.2011 ”Për Disa ndryshime në UKM NR. 3, datë 15.02.2001” dhe kushtet e kontratës nr. 604/6, datë 26.12.2017.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa e të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **595,300 lekë**, nga operatori ekonomik “C” sh.p.k., paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i ish Shkollës së vjetër Nivicë”, Bashkia Tepelenë.

Brenda muajit Dhjetor 2021

4. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka kryer pagesa të tepërta në vlerën, **330,200 lekë** ndaj operatorit ekonomik “L K” shpk., për përdorimin e fondit rezervë të pa argumentuar me punime të kryera, në objektin “Sinjalistikë e Infrastrukturës turistike midis zonave bregdetare dhe malore”, me vlerë të kontratës 8,995,266 lekë me TVSH në kundërshtim me pikën 3.2 dhe pikën 3.3, të UKM nr. 1, datë 16.06.2011 ”Për Disa ndryshime në UKM NR. 3, datë 15.02.2001” dhe kushtet e kontratës nr. 605/6, datë 26.12.2017.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa e të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **330,200lekë** nga operatori ekonomik “L K” sh.p.k., paguar për situacionimin dhe përdorimin e fondit rezervë të pa argumentuar, në objektin “Sinjalistikë e Infrastrukturës turistike midis zonave bregdetare dhe malore”, vendosur në rrugën Borsh-Nivicë-Tepelene dhe rrugën Nivicë-Ura e Kardhiqit.

Brenda muajit Dhjetor 2021

D.1. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: "Rijetëzimi i qendrës së fshatit Nivicë", Komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka vlerësuar si të vlefshme ofertën e BOE “M” shpk “N” shpk në vlerën 33.772.132 lekë “edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj. Kështu:

-Arkitekti ka licencën restauruese dhe logjikisht nuk mund të licencohej në rast se nuk ka diplomën përkatës.

-Për faktin e mungesës së auto betonierës, në kushtet e bashkimit të operatorëve “N” shpk e “M” shpk, megjithëse “N” shpk nuk ka auto betonierë, këtë e disponon M. Shpk me targë AA5964S.

Nisur nga fakti se ky operatorë kanë dhënë ofertë më të ulët se operatori fitues "E C C", me vlerë në total 35,246,405, diferenca mes te dyve është 1.474.273 lekë diferencë e cila ka shkelur kështu kriterin e vlerësimit të përcaktuar si çmimi më i ulët dhe oferta ekonomikisht më e favorshme komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka kërkuar sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Veprime në papajtueshmëri me pikën 4 neni 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe paragrafi i dytë pikës 3 neni 66 të VKM nr. 914 ,datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Titullari i AK të AKB nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punime civile/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën 1,474,273 leke, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Brenda muajit Dhjetor 2021

2. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: "Ndërtimi i kullave vrojtuese", nga shqyrtimi i procedurës së vlerësimit Komisioni i vlerësimit të ofertave **nuk ka vlerësuar si të vlefshme ofertën e OE "Z" shpk në vlerën 2.827.065 lekë** "edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka kërkuar sqarime nga ofertuesit, "Z" shpk të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal lidhur me arsyen e s`kualifikimit, nisur nga fakti se ky operatorë kanë dhënë ofertë më të ulët se operatori fitues "C", me vlerë në total 3.750.856, diferenca mes te dyve është 923.791 lekë diferencë e cila ka shkelur kështu kriterin e vlerësimit të përcaktuar si çmimi më i ulët dhe oferta ekonomikisht më e favorshme, në rast se do ishte kërkuar arsye për. Veprime në papajtueshmëri me pikën 4 neni 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe paragrafi i dytë i pikës 3 neni 66 të VKM nr. 914 ,datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Titullari i AK të AKB nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **923,791 leke**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Brenda muajit Dhjetor 2021

E. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 , Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", ndryshuar me Ligjin Nr. 183/2014, datë 24.12.2014 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i rekomandojmë, Kryeinspektorit të Inspektoratit

të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të Bashkisë Tepelenë të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 50,000 lekë për:**

- **Z. V B**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, drejtues ligjor dhe teknik i shoqërisë “B-V E” SHPK, ndryshuar emri në “N G” SHPK dhe licencë MK. 3101/1, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të ndërtimit, për Kontratën e zbatimit me Nr. Prot. 604/6, datë 26.12.2017, me objekt: “*Rikonstruktion i ish Shkollës së vjetër Nivicë*”, Bashkia Tepelenë, me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik “C” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 595,300 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

F. MASA DISIPLINORE:

I. Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me Ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë titullarit të institucionit, në varësi të analizës së përgjegjësive, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të trajtuar në Raportin Përfundimtar për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara për dhënien e masave disiplinore, si dhe:

1.Ti propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik(APP) për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit e cituar më poshtë, duke e zgjeruar dhe për punonjës të tjerë sipas gjykimit dhe vlerësimit të titullarit, si vijon:

1. Znj. K Th me detyrë specialist, **në cilësinë e anëtarit të (KVO)**, pasi:

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rijetëzimi i qendrës së fshatit Nivicë”, si anëtare e KVO-së nuk ka vlerësuar si të vlefshme ofertën e OE “M” shpk në vlerën 33,772,132 lekë, duke mos ju përmbajtur përcaktimeve ligjore, ku thuhet: “edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”, nisur nga fakti se ky operatorë kanë dhënë ofertë më të ulët se operatori fitues “E C C”, me vlerë në total 35,246,405, diferenca mes te dyve është 1.474.273 lekë diferencë e cila ka shkelur kështu kriterin e vlerësimit të përcaktuar si çmimi më i ulët dhe oferta ekonomikisht më e favorshme. Veprime në papajtueshmëri me pikën 4 neni 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikës 3 neni 66 të VKM nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 117-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Z. E H, specialist, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, pasi:

-**Në 1 rast**, për procedurën tenderuese për ekspertizë të jashtme për projektin IPA “Welcome” me vlerë 22,000 euro, për hartimin e specifikimeve teknike në kundërshtim me rregullat e Komisionit Evropian “PRAG” dhe cenimin e konkurrencës, trajtuar më hollësisht në Akt Konstatimit Nr.2 datë 19.06.2020.

-**Në 1 rast**, për procedurën tenderuese “Vlerësimi shëndetësor i stacioneve monitoruese” me vlerë 3500 euro, në cilësinë e anëtarit me të drejtë vote në komisionin e vlerësimit të ofertave ku është shpallur fitues një subjekt që nuk plotëson kriteret e specifikimeve teknike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 145-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-**Në 6 raste**, shpenzime me procedurë prokurimi për blerje me vlera vogla, **të bankës 2020 të AKB Tiranë**, u konstatua disa mangësi dhe shkelje me efekte financiare për vlerën **48,325 lekë**, konkretisht:

Shpenzime për gjoba për vlerën **2,000 lekë**, për tejkalim afati të kontrollit vjetor teknik të automjeteve me targa AA763NY dhe AA590PK, pasi kanë lejuar likuidimin nga fondet e AKB,

në vend të personave fajtor që nuk kanë respektuar afatet ligjore të kolaudimit mjeteve, sipas urdhër shpenzimeve nr. 23, datë 06.02.2020 dhe nr. 86, datë 09.03.2020.

Shpenzime për blerje me vlera vogla për vlerën **46,325 lekë**, përkatësisht:

vlera 24,960 lekë TVSH, për subjektin “B C” shpk, sipas urdhër shpenzimit nr. 212, datë 11.08.2020, shpenzime figuracioni TPL për 6 automjetet e institucionit, pasi fatura e subjektit nr. 6, datë 03.08.2020 është e parregullt dhe jo e modelit tatimor, sepse subjekti është person juridik dhe jo person fizik, çka ka krijuar evazion fiskal për vlerën 24,960 lekë TVSH. Gjithashtu subjekti “B C” shpk nuk është kompani sigurimesh por agjenci turistike, sipas QKB, madje 6 siguracionet ose TPL e automjeteve janë lëshuar nga një kompani tjetër sigurimesh “E” shpk, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” i ndryshuar, me pikën 52 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar kreun VI pika 2/ç, me VKM nr. 1149, datë 25.11.2009 “Për shtypin dhe shpërndarjen e dokumentit tatimor”.

vlera 21,365 lekë dëm ekonomik, diferencë çmimesh nga tregu për shpenzime mirëmbajtje 6 printer zyresh, sipas urdhër shpenzimit nr. 342, datë 23.11.2020

Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, me UMF nr. 33, datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.06.2014 “Për gjurmët standarde auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe- ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 63-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Znj. E D, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve,

4. Znj. A Z, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve,

5. Znj. G T, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit, pasi:

-**Në 6 raste**, shpenzime me procedurë prokurimi për blerje me vlera vogla, **të bankës 2020 të AKB Tiranë**, u konstatua disa mangësi dhe shkelje me efekte financiare për vlerën **48,325 lekë**, konkretisht:

Shpenzime për gjoba për vlerën **2,000 lekë**, për tejkallim afati të kontrollit vjetor teknik të automjeteve me targa AA763NY dhe AA590PK, pasi kanë lejuar likuidimin nga fondet e AKB, në vend të personave fajtor që nuk kanë respektuar afatet ligjore të kolaudimit mjeteve, sipas urdhër shpenzimeve nr. 23, datë 06.02.2020 dhe nr. 86, datë 09.03.2020.

Shpenzime për blerje me vlera vogla për vlerën **46,325 lekë**, përkatësisht:

vlera 24,960 lekë TVSH, për subjektin “B C” shpk, sipas urdhër shpenzimit nr. 212, datë 11.08.2020, shpenzime figuracioni TPL për 6 automjetet e institucionit, pasi fatura e subjektit nr. 6, datë 03.08.2020 është e parregullt dhe jo e modelit tatimor, sepse subjekti është person juridik dhe jo person fizik, çka ka krijuar evazion fiskal për vlerën 24,960 lekë TVSH. Gjithashtu subjekti “B C” shpk nuk është kompani sigurimesh por agjenci turistike, sipas QKB, madje 6 siguracionet ose TPL e automjeteve janë lëshuar nga një kompani tjetër sigurimesh “E” shpk, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” i ndryshuar, me pikën 52 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar kreun VI pika 2/ç, me VKM nr. 1149, datë 25.11.2009 “Për shtypin dhe shpërndarjen e dokumentit tatimor”.

vlera 21,365 lekë dëm ekonomik, diferencë çmimesh nga tregu për shpenzime mirëmbajtje 6 printer zyresh, sipas urdhër shpenzimit nr. 342, datë 23.11.2020

Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, me UMF nr. 33, datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.06.2014 “Për gjurmët standarde auditit për prokurimet me vlere te vogël dhe te larte”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 63-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Mungon procesverbali i komisionit të inventarizimit fizik të pasurisë të AKB, nuk bëhet fjalë për relacionin dhe sistemimin e diferencave etj. Disponohet një pasqyrë e inventarit kontabël, e cila është e parregullt, pasi nuk ka asnjë nënshkrim të komisionit, të magazinierit dhe të personave përgjegjës, madje kësaj pasqyre i mungon kolona e evidentimit të materialeve jashtë përdorimit, por paraqet kolonën e amortizimit që nuk ka lidhje me inventarizimin fizik. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,” dhe ligjin nr. 10296 date 10.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe dhe kontrollin”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 75-117, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.Të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të trajtuar në Raportin Përfundimtar për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit e cituar më poshtë, duke e zgjeruar dhe për punonjës të tjerë sipas gjykimit dhe vlerësimit të titullarit, si vijon:

1. Znj. E S, me detyrë specialiste Finance pas datës 03.08.2017,

- Për shkelje të dispozitave ligjore në fushën e pagave, në lidhje me pagesat e kryera për punonjësit me kontratë në zbatim të kërkesave të VKM nr. 586, datë 30.08.2019, bazuar në tabelën e pagave lidhja 1(nën lidhja 6), me një diferencë 11000 lekë (nga kategoria IV-a me kategorinë IV-b), vepruar në kundërshtim me interpretimin e pikave 4-5 të VKM nr. 16, datë 16.01.2019, dhe të pikës 5, të VKM nr. 47, datë 22.01.2020, për strukturën e miratuar për vitin 2020 (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Z. B C, me detyrë specialist, pasi:

-**Në 1 rast,** në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e referencave për procedurën tenderuese për ekspertizë të jashtme për projektin IPA “Welcome” me vlerë 22,000 euro, për hartimin e specifikimeve teknike në kundërshtim me rregullat e Komisionit Europian “PRAG”, (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 145-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Znj. M T, me detyrë specialiste finance, pasi:

-Mungon procesverbali i komisionit të inventarizimit fizik të pasurisë të AKB, nuk bëhet fjalë për relacionin dhe sistemimin e diferencave etj. Disponohet një pasqyrë e inventarit kontabël, e cila është e parregullt, pasi nuk ka asnjë nënshkrim të komisionit, të magazinierit dhe të personave përgjegjës, madje kësaj pasqyre i mungon kolona e evidentimit të materialeve jashtë përdorimit, por paraqet kolonën e amortizimit që nuk ka lidhje me inventarizimin fizik. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,” dhe ligjin nr. 10296 date 10.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe dhe kontrollin”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 75-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. B K, në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit,

5.K L, në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit, pasi:

-Mungon procesverbali i komisionit të inventarizimit fizik të pasurisë të AKB, nuk bëhet fjalë për relacionin dhe sistemimin e diferencave etj. Disponohet një pasqyrë e inventarit kontabël, e cila është e parregullt, pasi nuk ka asnjë nënshkrim të komisionit, të magazinierit dhe të personave përgjegjës, madje kësaj pasqyre i mungon kolona e evidentimit të materialeve jashtë përdorimit, por paraqet kolonën e amortizimit që nuk ka lidhje me inventarizimin fizik. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e

sektorit publik,” dhe ligjin nr. 10296 date 10.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 75-117, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Të njoftohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, që mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me Ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, që në varësi të analizës së konstatimeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë së Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së **Z. L L**, për sa trajtuar në Raportin Përfundimtar për dhënien e masës disiplinore, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, pasi:

- Në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nuk ka menaxhuar sipas rregullave të BE-së (PRAG, Guida praktike për procedurat kontraktues të jashtme të BE-së dhe Manuali i Prokurimit IPA)procedurat tenderuese për ekspertizë të jashtme për projektet IPA “Welcome”, Reglport dhe “Blue Cost”, në kuadër të instrumentit për asistencën e para anëtarësimi IPA II”, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 37/2015, datë 22.12.2016, Neni 18 “Rregullat për prokurimin dhe dhënien e granteve”, pika 2 ku përcaktohet se “Të gjitha kontratat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve, si edhe marrëveshjet e grantit jepen dhe zbatohen në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuar prej Komisionit për zbatimin e aksioneve të jashtme që janë në fuqi në momentin e shpalljes së procedurës në fjalë, përveç kur parashikohet ndryshe në Marrëveshjen Sektoriale apo atë të Financimit” (trajtuar në Akt Konstatimin Nr. 2, datë 19.06.2020 dhe në faqet 145-163, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte **Vërejtje me shkrim**” deri në **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, përkatësisht:

- Për **Z. A T**, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, në cilësinë e ish/Titullarit të Autoritetit Kontraktor;

- Për **Znj. A A** me detyrë ish specialiste, në cilësinë e anëtarit të KVO;

- Për **Z.K K**, përfaqësues i ish/ Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (caktuar me Urdhrin nr. 260, datë 21.04.2017), në cilësinë e kryetarit të KVO.

- Për **Z. B F**, me detyrë ish specialiste, në cilësinë e anëtarit të KVO;

- Për **Z. G M**, me detyrë ish specialiste, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit;

- Për **Z R B** përfaqësues i ish/ Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (caktuar me Urdhrin nr. 603/2, datë 12.08.2016), në cilësinë e kryetarit të KVO.

-Për të metat e mangësitë e konstatuara, në procedurat e prokurimit publik veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 66-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Për **Znj. V K** me detyrë specialiste finance, për likuidime DRSHTRR Tiranë 2,000 lekë gjoba, për tejkallim afati për kontrollin vjetor teknik të automjeteve

Për punonjësen znj. E Ç, nuk do të rekomandojmë masë për shkak se janë rekrutuar në AKB, si studente ekselence në Mars 2019 dhe janë në periudhë prove, të rekrutuar në kuadër të Vendimit Nr. 766, datë 26.12.2018

Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019”. Përfshirja në këto grupe kërkon eksperiencë pune dhe njohuri

mbi rregullat e tenderimit të BE-së, ndaj personat e përzgjedhur duhet të plotësojnë këto kërkesa ligjore.

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët rekomandohen masat disiplinore, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Sektori i burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

K R Y E T A R

ARBEN SHEHU